

RAPORT MONITORIMI

# UNIVERSITETET NË SITËN E TRANSPARENCËS FINANCIARE

VITI AKADEMIK 2022 – 2023



QENDRESA  
QYTETARE



FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG





**Realizuan:**

Autor: Rigels Xhemollari

**Ekspertë monitorimi:**

Besjana Hysa

Dragana Kurti

Kolindo Vjerdha

*Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.*

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

### **1. KONTEKSTI**

### **2. CFARË JANË BORDET E ADMINISTRIMIT?**

### **3. METODOLOGJIA**

### **4. GJETJET KRYESORE**

### **5. ANALIZË E SHPENZIMEVE NË 7 UNIVERSITETE PUBLIKE**

#### **5.1 Kategoria “ Shpenzime Personeli”**

#### **5.2 Kategoria “ Investime”**

#### **5.3 Kategoria “Blerje mallrash”**

#### **5.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”**

#### **5.5 Kategoria “Bursa dhe transferta për subvencione të tjera”**

### **6. TRANSPARENCA E UNIVERSITETEVE PUBLIKE**

### **7. REKOMANDIME**



## KONTEKSTI

Qëndresa Qytetare është një organizatë e fokusuar tek fuqizimi i rolit të qytetarit në shoqëri dhe synon përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet angazhimit dhe aktivizmit qytetar. Nisur nga mungesa e shërbimeve ndaj studentëve në universitetet publike, ankesat e shumta prej tyre dhe tarifat që aplikojnë universitetet, Qëndresa Qytetare tashmë e ka shndërruar në praktikë të mirë monitorimin e shpenzimeve financiare të universiteteve publike çdo vit akademik prej vitit 2017 – 2018.

Vlera e këtij monitorimi konsiston jo vetëm në përdorimin e të dhënave nga studentë, pedagogë, drejtues akademikë apo administrativë, vetë qeveria apo KLSH në kuadër të auditimeve, por edhe ekspertë që kanë interes të studiojnë menaxhimin e universiteteve publike.

Në kuadër të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ndryshimeve që institucionet e arsimit të lartë përsuan sa i takon menaxhimin financiar dhe administrimit, **Qëndresa Qytetare monitoroi shtatë universitete publike** me fokus investimet dhe nivelin e transparencës së tyre në raport me publikun dhe studentët për **periudhën 1 shtator 2022 – 31 gusht 2023**.

Ky monitorim shërben për të hedhur dritë mbi mënyrën se si janë shpenzuar të ardhurat që grumbullohen nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat që vijnë nga buxheti i shtetit duke u munduar për ti dhënë një përgjigje pyetjes nëse reflektohen nevojat reale të studentëve apo kemi të bëjmë me një administrim jo efektiv të buxhetit vjetor të universiteteve?

Gjithashtu kjo nismë adreson problematikën e integritetit, legjitimitetit dhe efektivitetit të Bordeve të Administrimit, marrëdhënies që ata kanë krijuar me drejtuesit akademikë, pedagogët, studentët dhe nivelin e komunikimit me këto kategori që popullojnë universitetin. A shkojnë paratë e studentëve tek studentët? A i plotësojnë universitetet publike nevojat financiare të stafëve akademike? Këto dhe shumë pyetje të tjera do të përpiqemi t'u japim përgjigje nëpërmjet analizimit të të dhënave të përfituara nga monitorimi i 7 universiteteve publike.

Qëndresa Qytetare përmes këtij monitorimi synon të nxisë llogaridhënien publike të universiteteve ndaj studentëve dhe të stimulojë një nivel më të lartë transparence, nëpërmejt pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në vendimmarrje.

## CFARË JANË BORDET E ADMINISTRIMIT?

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme.

3 Anëtarë, përfaqësues të institucionit publik të arsimit të lartë, përzgjidhen nga Senati Akademik i institucionit përkatës, 4 Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin do të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike dhe emërohen nga ministri përgjegjës për arsimin.

Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga Bordi i Administrimit. Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura.

Ministri përgjegjës për arsimin deri në vitin 2021 emëronte një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësonin të njëjtat kritere si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Në përgjigje të kërkesave të studentëve dhe nën presion të nevojës për transparencë, Minsitri i Arsimit vendosi që pas vitit 2021 përfaqësuesit e studentëve në këto borde të zgjidhen me votë nga vetë studentët, proces pati pak pjesëmarrje dhe shumë kontestime.

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.

Në institucionet jopublike të arsimit të lartë administratori emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve në statutin e institucionit. Administratori i institucionit publik të arsimit të lartë shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.



## METODOLOGJIA

Ekipi i monitoruesve të Qëndresës shfrytëzoi dhe gërshetoi një sërë burimesh të informacionit. Monitorimi u bazua në analizën ligjore të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë sa i përket organeve të administrimit financiar në universitete dhe shqyrtimit të të dhënave të përfituara nga **transaksionet e thesarit**.

Gjetjet e analizuara të transaksioneve të thesarit u pasuruan me të dhënat e përfituara nga shfletimi i **buletinit të prokurimeve publike**, ku duken qartazi kontrata dhe objektet e marrëveshjeve që titullarët e universiteteve publike lidhin me operatorë të tretë për shërbime dhe produkte në plotësim të nevojave të universitetit.

Njëkohësisht, plot **14 kërkesa për informacion** drejtuar universiteteve të përzgjedhura u dërguan në lidhje me buxhetin, investimet dhe destinacionin e parave të mbledhura nga tarifat e studentëve.

Në këtë analizë janë konsultuar edhe raportet e auditimit të KLSH në universitetet publike.

### **Në shqyrtim janë marrë të dhënat e 7 universiteteve publike konkretisht:**

- Unversiteti i Tiranës
- Univeristet i "Aleksandër Xhuvani" Elbasan
- Universiteti "Fan Noli" Korcë
- Universiteti i Mjeksisë Tiranë
- Univeristet i "Aleksandër Moisiu" Durrës
- Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër
- Universiteti Politeknik i Tiranës



## GJETJET KRYESORE

- Shtatë universitetet publike të monitoruara kanë shpenzuar shifra të konsiderueshme në zërin *honorare dhe shpërblime për personelin*, të kryesuara nga **UPT me 1.5 milion Euro, Universiteti i Elbasanit me 555 900 Euro** dhe **UT me 391 400 Euro honorare dhe shpërblime**.
- Pavarësisht se në vitin 2019 u shpenzuan 170 000 Euro për rikualifikimin e oborrit të Fakultetit të histori – filologjisë, Unviersiteti i Tiranës ka shpenzuar edhe **283 800 Euro për mirëmbajtje ndërtese dhe ambienti rrethues**, ku vetëm FHF dhe FEUT rezultojnë me një mur rrethues.
- Universiteti i Elbasnit ka shpenzuar 562 000 Euro për sigurimin në një vit të godinës së tij me 19 roje në dispozicion, ndërsa UT ka shpenzuar **694 668 Euro për ruajtjen e godinave**.
- Sipas Vendimit të Këshilit të Minsitrave nr. 177, 2019 të gjitha institucionet publike duhet të lidhin kontratë me kompaninë shtetërore *Illyrian Guard Sh.a* për sigurinë e godinave të tyre, ndërkohë që **Universiteti i Elbasnit e ka lidhur kontratën me kompaninë UEVI -2015 shpk**.
- Shtatë universitete publike kanë shpenzuar në total **50 000 Euro për zërin e karburantit dhe vajit**, shifër e cila shpenzohej nga vetëm një universitet në vitet e shkuara. Madje dy universitete, UT dhe UPT nuk kanë shpenzime për këtë nënkategori.
- Shtatë universitetet publike kanë shpenzuar në total 79 000 Euro për studime dhe kërkime shkencore nga 42 milion Euro të shpenzuara në total. Ndërkohë Universiteti i Tiranës ka shpenzuar **380 000 Euro** për blerjen e mobiljeve dhe orendive në zërin e investimeve.
- UPT ka shpenzuar **221 000 Euro** për rinovimin e sallës “Silvano Pedrollo” në brendësi të Rektoratit, sallë e cila ishte në gjendje të mirë infrastrukturore.
- Portali **u-transparenca ka dalë jashtë funksionit dhe nuk përmban më të dhënat mbi** prokurimet, kontratat e IAL-ve me të tretët dhe cv e pedagogëve. Ky bllokim i portalit përbën shkelje të VKM nr. 781 për garantimin e transparencës së institucioneve të arsimit të lartë.

## ANALIZË E SHPENZIMEVE NË 7 UNIVERSITETE PUBLIKE

Monitoruesit dhe ekspertët e Qëndresës Qytetare kanë kaluar në sitë dhe kanë përpunuar në mënyrë të thjeshtëzuar të gjitha transaksionet që kanë kryer shtatë universitetet publike duke përfshirë të gjitha kategoritë e shpenzimeve gjatë periudhës **1 shtator 2022 – 31 gusht 2023**.

Nëpërmjet kalimeve të vlerave tek të tretët apo personeli duke marrë në konsideratë edhe përshkrimin e çdo transaksioni, është bërë i mundur edhe evidentimi i pagesave dhe transfertave të dyshimta apo të pa justifikuar.

Ekipi i monitoruesve ka identifikuar një sërë transaksionesh të ndara sipas kategorive të cilat nuk përputhen as me vlerat normale të pagesave, as me nevojat që mund të ketë një universitet publik, parë në raport me buxhetin e tij total.

### Gjatë kësaj periudhe në total këto 7 Universitete kanë shpenzuar në total:

- Unversiteti i Tiranës (Rektorat) 5,458,427 Euro në 796 transaksione
- Univeristeti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 6,637,832 Euro në 315 transaksione
- Universiteti Korçë 3,684,325 Euro në 331 transaksione
- Universiteti i Mjeksisë (Rektorat) 937 410 Euro në 242 transaksione
- Univeristeti “Aleksandër Moisiu” Durrës 8,202,595 Euro në 898 transaksione
- Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 4,533,188 Euro në 499 transaksione
- Universiteti Politeknik i Tiranës 12 910,877 Euro në 2158 transaksione

Universiteti Politeknik i Tiranës ka shpenzuar më shumë në vlerë dhe një kohësisht ka kryer dhe numrin më të madh të transaksioneve. Por Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Mjekësisë Tiranë i ka të decentralizuara në thesar shpenzimet për njësitë kryesore të universitetit dhe shpenzimet e mësipërme i referohen vetëm atyre të realizuara nga rektoratet e dy universiteteve.

Sic kuptohet nga tabela, shpenzimet e Universiteteve sipas zërave të kategorive shkojnë pak a shumë në propocion të rregullt me shpenzimet totale te secilit prej tyre.

### Sipas kategorive të shpenzimeve Universitetet kanë shpenzuar si më poshtë:

Kategori	U.Shkodres	U. Tiranës	U. Elbasanit	U.Korces	U.Durrësit	UPT	UMT
II Shpenzime personeli	344,188,287	114,328,866	383,992,760	286,771,784	582,242,911	881,766,990	49,772,495
III Investime	19,790,697	144,703,664	10,456,392	4,243,135	100,968,895	194,051,871	25,679,380
IV Blerje mallrash	25,684,641	144,957,587	37,302,292	25,428,471	41,550,455	81,513,325	5,255,037
V Sigurimi i shërbimeve	33,679,028	158,883,081	149,598,271	28,243,304	62,849,471	72,822,788	16,514,473
VI Transferta dhe Subvencione	1,316,644	9,941,116	358,702	702,500	8,057,467	6,773,669	325,791
VII Të tjera	51,325,000	325,600	115,264,000	41,465,000	65,603,376	118,713,448	880,960
<b>Totali</b>	<b>475,984,297</b>	<b>573,139,914</b>	<b>696,972,417</b>	<b>386,854,194</b>	<b>861,272,575</b>	<b>1,355,642,091</b>	<b>98,428,136</b>



## 5.1 Kategoria “ Shpenzime Personeli”

Kategoria e shpenzimeve të personelit është ndër kategoritë që zënë poeshën kryesore të shpenzimeve të universiteteve. Nga tabela e transaksioneve vihet re se Universiteti që ka shpenzuar më shumë para për “Dieta dhe udhëtime” është Universiteti Politeknik i Tiranës me 227 141 euro, ndërsa universitetet e Shkodrës, Durrësit dhe Elbasanit kanë shpenzuar nga rreth 50 000 euro për këtë kategori në 1 vit kalendarik. Ndërkohë është sërish UPT ai që shpërblen në shifra më të larta Bordet e Administrimit dhe Senatit Akademik me vlerë 121 600 euro.

Ajo çka bie në sy në zërin e shpenzimeve të personelit është që Universiteti i Tiranës dhe ai i Shkodrës nuk kanë bërë asnjë shpenzim në zërin **2.2 Paga me kontratë për kohë të kufizuar** ndërsa UAMD është universiteti që ka shpenzuar më shumë për këtë zë, ku vihet re se është i vetmi universitet që ka angazhuar lektorë të huaj me kohë të kufizuar.

	Kategori/Nënkategori	U.Shkodrës	U.Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U.Durrësit	U.P.Tiranës	UMT
II	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>344,188,287</b>	<b>114,328,866</b>	<b>383,992,760</b>	<b>286,771,784</b>	<b>582,242,911</b>	<b>881,766,990</b>	<b>49,772,495</b>
2.1	Paga	329,487,478	63,750,506	308,707,234	266,495,376	518,906,165	658,492,185	36,141,809
2.2	Honorare + Te tjera shperblime per personelin	8,867,905	41,096,966	58,370,775	4,825,689	17,834,188	157,622,707	12,247,652
2.3	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	0	0	1,278,825	10,422,464	32,197,387	29,034,392	142,185
2.4	Dieta Udhetime	5,756,404	9,481,394	5,552,058	3,540,755	5,257,371	23,849,888	790,349
2.5	Pagesa anetaret e bordit administrative (+Senati)	76,500	0	10,083,868	1,487,500	8,047,800	12,767,818	450,500

Universitetet kanë shpenzuar shifra të konsiderueshme në zërin “Honorare dhe shpërblime” për personelin, të kryesura nga UPT me 1.5 milion Euro, Universiteti i Elbasanit me 555 900 Euro dhe UT me 391 400 Euro honorare dhe shpërblime.

<b>UNIVERSITETI I TIRANËS</b>	
2. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor	Emri <b>UNIVERSITETI I TIRANËS</b> Adresa Biv. “Disimorët e kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë Tel/Fax Tel: +35542238446 E-mail s_dafa@unitir.edu.al Faqja në Internet www.unitir.edu.al
3. Lloji i procedurës së prokurimit:	E hapur, e thjeshtuar.
4. Objekti i kontratës:	“Organizim Ceremonia e 65 vjetorit të UT-se”
5. Numri i referencës së procedurës:	REF-38003-08-05-2022
6. Fondi limit:	5,415,900 (pesëmilion katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSh.
6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nënkontraktimin):	6,324,000 (gjashtëmilion treqind e njëzet e katërmijë) lekë me TVSh.
7. Data e lidhjes së kontratës:	16.09.2022.
8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nënkontraktorit:	“ICEBERG Communication” shpk, me adresë: Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Nd 32, H26 (6), Tiranë, me Nipt K315180775.

Një risi e praktikuar nga tre universitete gjatë këtij viti akademik janë ceremonitë e përvjetorëve të universiteteve ku jo pak para janë shpenzuar për organizimin e tyre. Universiteti i Tiranës në kuadër të 65 vjetorit të universitetit ka shpenzuar **60 000 Euro**, ndërsa Universiteti i Mjekësisë Tiranë **41 000 Euro** në kuadër të 70 vjetorit të institutit të Lartë Mjekësor dhe unviersiteti i Shkodrës në kaudër të 65 vjetorit të tij ka shpenzuar **21 150 Euro**.

## 5.2 Kategoria “ Investime”

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:  
Emri **Universiteti Politeknik i Tiranës**  
Adresa sheshi “Nene Tereza”, nr. 4, Tiranë  
Tel/Faks  
E-mail [aderaldo.mema@yahoo.com](mailto:aderaldo.mema@yahoo.com)  
Ueb-faqe [www.upt.al](http://www.upt.al)
2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur
3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: ) REF-72595-06-15-2023
4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Furnizim–vendosje pajisje për rinovimin e sallës Silvano Pedrollo të Rektoratit të UPT ”

---

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 28/513

---

**Buletini Nr. 55 datë 19 Qershor 2023** Agjencia e Prokurimit Publik

5. Fondi limit: 23,340,373.59 (njëzetë e tre milion e treqind e dyzetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre presje pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 60 ditë nga lidhja e kontratës.
7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: (d/m/v) Data: 17/07/2023 Ora:10:00

masë nga universitetet, vihet re një kujdes i treguar nga drejtuesit e universiteteve në këtë zë të thesarit.

Universiteti Politeknik i Tiranës ka shpenzuar 1.4 milion Euro në zërin **Mjete dhe Pajisje Teknike** dhe rreth 389 000 Euro për rikonstrukcion të ndërtesave.

**UNIVERSITETI I TIRANËS**

2. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor  
Emri **UNIVERSITETI I TIRANËS**  
Adresa Biv. “Dëshmorët e kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë  
Tel/Fax Tel. +35542258446  
E-mail [s.dalla@unitir.edu.al](mailto:s.dalla@unitir.edu.al)  
Faqja në Internet [www.unitir.edu.al](http://www.unitir.edu.al)
2. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur.
3. Objekti i kontratës: “Furnizim vendosje pajisje mobilimi për UT”.
4. Numri i referencës së procedurës: REF-42829-09-21-2022
5. Fondi limit: 39,980,900 (tridhjetë e gjashtëmilion treqind e tridhjetë e tremijë katërqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSh.

---

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 611/750

---

**Buletini Nr. 173 datë 19 Dhjetor 2022** Agjencia e Prokurimit Publik

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës: 45,651,420 (dyzet e pesëmilion gjashtëqind e pesëdhjetë e njëmijë katërqind e njëzet) lekë me TVSh.
7. Data e lidhjes së kontratës: 12.12.2022.
8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nëkontraktorit:  
“ERALD” shpk, me adresë: Rruga Nationale Tiranë-Fushë Krujë, Km 13, ndërtesë private 1 katëshe, Nikël, Durrës, me NIPT J74517205P

ndërrhyrjeve të vogla në mure, fakt që hedh dyshime për shpërdorim të fondit të vënë në dispozicion.

Shtatë universitetet publike kanë shpenzuar në total 79 000 Euro për studime dhe kërkime shkencore nga 42 milion Euro të shpenzuara në total. Ndërkohë Universiteti i Tiranës ka shpenzuar **380 000 Euro** për blerjen e mobiljeve dhe orendive.

Në kategorinë Investime është UPT është universiteti që ka kryer shpenzimet më të larta me total vlerën 1,848,113 euro ku peshën kryesore e zë blerja e mjeteve dhe pajisjeve teknike me vlerë 1,413,220 euro.

Zëri ku asnjëri nga Universitet nuk kanë bërë asnjë shpenzim këtë periudhë është zëri për **zëri për mjete transporti**. Pas denoncimit në media nga Qëndresa Qytetare në vitin 2018 - 2019 të blerjeve të makinave luksoze dhe karburantit në

Një ndër investimet që bie në sy për shifrën e lartë të shpenzuar në UPT është rinovimi i sallës Silvano Pedrollo në brendësi të rektoratit në vlerën **221 000 Euro**. Ekipi i Qëndresës ka vëzhguar nga afër sallën dhe ka evidentuar se salla pavarësisht se ishte në gjendje të mirë infrastrukturore, është bërë një investim në shifër të lartë.

Ajo që vihet re nga studentët dhe monitoruesit në terren, kjo sallë vetëm po i nënshtrohet një lysterje dhe

I vetmi universitet që nuk ka kryer shpenzime në zërin **Studime dhe Kërkime** është Universiteti i Mjekësisë Tiranë.



**FOTO E SALLËS “SILVANO PEDROLLO” NË UPT, PËRPARA DHE GJATË NDËRHYRJEVE PËR RINOVIMIN I CILI KA KUSHTUAR 221 000 EURO**

	Kategori/Nënkategori	U.Shkodrës	U.Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U.Durrësit	U.P.Tiranës	UMT
III	<b>Investime</b>	<b>19,790,697</b>	<b>144,703,664</b>	<b>10,456,392</b>	<b>4,243,135</b>	<b>100,968,895</b>	<b>194,051,871</b>	<b>25,679,380</b>
3.1	Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	1,319,342	9,814,864	5,602,389	415,200	91,982,887	40,962,422	0
3.2	Pajisje pastrimi	0	10,488,480	1,783,248	0	0	1,477,200	0
3.3	Mjete transporti	0	0	0	0	0	0	0
3.4	Mjete dhe pajisje teknike	14,497,860	71,943,150	249,643	2,550,336	1,821,612	148,388,115	25,679,380
3.5	Pajisje zyre dhe orendi të tjera	901,200	50,369,170	2,381,112	437,599	6,936,180	1,586,160	0
3.6	Studime dhe kërkime	3,072,295	2,088,000	440,000	840,000	228,216	1,637,974	0

### 5.3 Kategoria “Blerje mallrash”

Prej 5 vitesh Qëndresa Qytetare ka ngritur në media dhe institucione të hetimit shqetësimin se universitetet publike përdorin shuma të mëdha në zërin e karburantit. Gjatë këtij viti kalendarik vihet re një reduktim i shpenzimeve për karburant nga IAL-të publike. Shtatë universitete publike kanë shpenzuar në total 50 000 Euro në total për zërin e karburantit dhe vajit, shifër e cila shpenzohej nga vetëm një universitet në vitet e shkuara. Madje dy universitete, UT dhe UPT nuk kanë shpenzime për këtë nënkategori.



**UNIVERSITETI I TIRANËS**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:  
 Emri **UNIVERSITETI I TIRANËS**  
 Adresa Blv. "Dëshmorët e kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë  
 Tel/Fax Tel. +35542258446  
 E-mail s\_dafa@unitir.edu.al  
 Ueb Faqe www.unitir.edu.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-45854-10-13-2022

4. Objekti i kontratës: Blerje materiale pastrimi dhe detergjentë për UT.

5. Fondi limit: 10,857,600 (dhjetëmilion tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë gjashtëqind) Lekë pa TVSh.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 60 ditë.

---

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.aop.gov.al> 52/478

---

Buletini Nr. 143 datë 17 Tetor 2022 Agjencia e Prokurimit Publik

---

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 31/10/2022; Ora: 11:00.

Nga shtatë universitete, vetëm universiteti i Shkodrës nuk ka blerë asnjë liber, ndërsa gjashtë universitetet e tjera kanë kryer shpenzime për këtë kategori në vlerën totale 225 337 Euro.

Në kategorinë "Blerje Mallrash" Universiteti i Tiranës mban vendin e parë me shpenzime në zërin **Pajisje Informatike** në vlerën e 1,046,657 Euro. Një ndër tenderat e identifikuar është me përshkrimin

pajisje elektronike për ndërkombëtarizimin në vlerën 110 000 Euro, por ky universitet nuk ka pranuar të vejë në dispozicion detajet e këtyre kontratave.

Universiteti i Tiranës ka shpenzuar për një seri blerje mallrash të cilat hedhin dyshime për keqpërdorimin e parave të tarifave të studentëve ku mund të theksojmë blerje ari dhe argjendi për studentët **45 900 Euro**, bojë printeri dhe letra A4 160 000 Euro dhe detergjentë **103 100 Euro**.

Ndërkohë Universiteti i Elbasanit ka reduktuar shpenzimet për ujë nga vlera 33 000 Euro në vitin 2019 në vlerën 15 000 Euro, por vijon të ketë shifra të larta sa i përket mirëmbajtjes së databazave të cilat shkojnë në vlerën 117 000 Euro.

	Kategori/Nënkategori	U.Shkodrës	U.Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U.Durrësit	U.P.Tiranës	UMT
IV	<b>Blerje mallrash</b>	<b>25,684,641</b>	<b>144,957,587</b>	<b>37,302,292</b>	<b>25,428,471</b>	<b>41,550,455</b>	<b>81,513,325</b>	<b>5,255,037</b>
4.1	Energji elektrike	6,767,027	1,083,952	6,863,052	4,018,257	19,714,941	21,041,146	605,355
4.2	Karburant dhe vaj	881,994	0	1,074,888	217,200	3,133,728	0	19,000
4.3	Ujë	1,082,446	91,008	1,568,954	1,201,400	1,885,616	2,695,290	0
4.4	Ngrohje + Pastrim	9,771,795	6,878,677	886,080	7,890,383	1,342,392	314,760	0
4.5	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	2,356,821	8,617,560	2,225,979	1,058,091	7,720,930	3,543,783	1,659,307
4.6	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	4,687,368	7,292,426	1,086,195	129,400	2,257,951	1,367,557	1,431,600
4.7	Libra dhe publikime profesionale	0	5,335,475	7,404,364	4,562,035	2,788,739	3,434,225	135,563
4.8	Materiale dhe shërbime operative	137,190	5,663,404	1,550,413	2,632,025	2,706,158	6,015,357	312,680
4.9	Pajisje Informatike	0	109,899,085	14,642,367	3,719,680	0	41,983,582	1,091,532
4.10	Materiale të tjera	0	96,000	0	0	0	1,117,625	0

## 5.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”

Nga monitorim i Qëndresës Qytetare rezulton se drejtuesit e të gjitha universiteteve publike vazhdojnë të shpenzojnë shuma të mëdha të parave të studentëve për të lidhur kontrata për sigurinë e godinave. Nevojitet një analizë e thelluar për të ripërcaktuar nevojat që kanë IAL-të dhe godinat e tyre bazuar në rëndësinë që paraqesin për ta mbuluar me siguri fizike. Gjithashtu bie në sy disproporcioni mes godinave dhe shumave të paguara për sigurinë e ndërtesave.

**Universiteti i Tiranës shpenzon 694 668 Euro për ruajtjen e godinave, ndërsa ai i Elbasanit 533 568 Euro.**

Sipas aneksit shoqërues të kontratës, godinat e universitetit të Elbasanit sigurohen me **19 roje**.

Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr vendorjeve)	Çmimi lekë /muaj	Oferta në total (neto)
1	Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me roje fizike me tre turne 24 ore me koeficient 4.98	12	9	404,990.38	43,738,961.04
2	Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me roje fizike me nje turne i pare 8 ore me koeficient L.66	12	4	116,233.20	5,579,193.60
3	Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me sistem elektronik objekteve	12	6	0.01	0.72
SHUMA PA TVSH					49,318,155.36
TVSHI 20%					9,863,631.07
SHUMA ME TVSH					59,181,786.00

Kjo kontratë u përpliu në katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin.  
Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të dyja palët, të cilët e firmosen dhe e vulosën atë respektivisht në çdo faqe.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR  
Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"  
ADMINISTRATORI  
Eljan Hoxha

PËR KONTRAKTUESIN  
"UEVI-2015" shpk  
ADMINISTRATOR  
Fatbardha Boka

Vihen re shpenzime të larta nga UT dhe Universiteti i Elbasanit lidhur me zërin instalime dhe mirëmbajtje rrjetesh informatike, ku UT ka shpenzuar 345 700 Euro ndërsa Universiteti i Elbasanit 590 000 Euro.

Gjithashtu në tabelën më poshtë Qëndresa ka bërë transparente të gjitha transaksionet që universitetet kanë shpenzuar për këtë nënkategori shpenzimi për periudhën e marrë në monitorim. Sipas Vendimit të Këshilit të Ministrave nr. 177, 2019 të gjitha institucionet publike duhet të lidhin

kontratë me kompaninë shtetërore Illyrian Guard Sh.a për sigurinë e godinave të tyre, ndërkohë që Universiteti i Elbasanit e ka lidhur kontratën me kompaninë UEVI -2015 shpk.<sup>1</sup>

Përsa i përket shpenzimeve për **Telefon dhe Internet** është **UPT që ka shpenzimet më të larta me vlerë 25 832 Euro**. Ndërkohë vihen re ndryshime të dukshme në zërin e “Sigurimit të Ndërtesave”, ku kemi një rritje të dukshme të shpenzimeve të kryera nga UPT por një ulje e këtyre shpenzimeve të kryera nga UAMD dhe UMT.

Në këtë vit kalendarik zëri i mirëmbajtjes së godinave dhe ndërtesave zë një peshë të lartë për disa universitete, zë i cili është materializuar shpesh në rrethime dhe gardhe rrethuese të ambienteve universitare.

<sup>1</sup> <https://qbz.gov.al/share/7BFHA4QIS0GepMngbgIclQ>

### UNIVERSITETI I TIRANËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:  
Emri **UNIVERSITETI I TIRANËS**  
Adresa Biv. "Dëshmorët e kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë  
Tel/Fax Tel. +35542258446  
E-mail s\_dafa@unitir.edu.al  
Web Faqe www.unitir.edu.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar
3. Numri i referencës së procedurës: REF-73792-06-27-2023
4. Objekti i kontratës: Mirëmbajtje ndërtese dhe ambienti rrethues për UT
5. Fondi limit: 29,884,705.46 (njëzet e nëntë milion tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë shtatëqind e pesë pesëqind e gjashtë) Lekë pa TVSh.
6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 60 ditë
7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 14/07/2023 ; Ora: 11:00

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 48/462

Universiteti i Tiranës ka nënshkruar një kontratë për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe të ambientit rrethues në vlerën 283 000 Euro, kujtojmë këtu që ky universitet ka ambient rrethues vetëm përpara fakulteteve të ekonomisë dhe filologjisë. Ndërkohë i njëjti universitet në një vit

ka shpenzuar edhe 31 800 Euro për kangjellat rrethuese të kopshtit botanik.

	Kategori/Nënkategori	U.Shkodrës	U.Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U.Durrësit	U.P.Tiranës	UMT
V	<b>Sigurimi i shërbimeve</b>	<b>33,679,028</b>	<b>158,883,081</b>	<b>149,598,271</b>	<b>28,243,304</b>	<b>62,849,471</b>	<b>72,822,788</b>	<b>16,514,473</b>
5.1	Posta dhe shërbimi korrier	110,470	100,516	55,705	32,155	69,780	226,397	855,170
5.2	Telefon dhe internet	377,051	958,221	2,620,069	198,658	52,475	2,712,457	17,800
5.3	Pastrim dhe gjelbërim	938,712	1,862,145	0	48,000	659,333	347,626	672,924
5.4	Shërbime të tjera transporti	194,046	978,795	560,412	601,841	204,420	1,603,550	0
5.5	Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	30,526,113	72,940,179	56,024,734	24,946,992	23,579,553	39,039,218	5,108,976
5.6	Shërbime të tjera	0	1,438,600	3,652,720	0	2,273,411	3,526,383	0
5.7	Aktivitetet sociale për personelin	1,141,676	8,133,322	2,316,225	1,557,298	6,158,760	9,361,036	9,249,870
5.8	Mirëmbajtje ndërtesash	0	27,761,822	19,177,086	0	0	5,448,222	117,600
5.9	Instalim dhe mirëmbajtje rrejtësh informatike	0	36,299,022	61,961,734	694,560	25,888,400	8,357,619	115,093
5.10	Mirëmbajtje të tjera	390,960	8,410,459	3,229,586	163,800	3,963,339	2,200,280	377,040

## 5.5 Kategoria "Bursa dhe transferta për subvencione të tjera"

Të shtatë Universitet kanë bërë shpenzime të konsiderueshme në zërin Komisione Bankare/ të tjera tek individët ku një pjesë e mirë e tyre janë rikthim shumash të kaluara gabim nga studentët në llogari të universiteteve. Përsa i përket mbështetjes financiare me bursa studimi dhe mbështetje të nxënësve të dalluar, këtë vit është UPT që ka vlerën më të lartë prej rreth 1 milion Eurosh.


Vetëm Universiteti i Korçës nuk ka kryer transferta për projekte ndërkohë Universiteti i Elbasanit nuk kryer shpenzime për kuota anëtarësimi në projekte.



	Kategori/Nënkategori	U.Shkodrës	U.Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U.Durrësit	U.P.Tiranës	UMT
VI	<b>Transferta dhe Subvencione</b>	<b>1,316,644</b>	<b>9,941,116</b>	<b>358,702</b>	<b>702,500</b>	<b>8,057,467</b>	<b>6,773,669</b>	<b>325,791</b>
6.1	Transferta për projekte	330,615	3,290,015	214,044	0	3,822,216	2,891,870	8,731
6.2	Kuota Antaresimi	731,529	912,628	0	100,000	1,376,106	1,811,884	241,700
6.3	Komisione Bankare/ të tjera tek individë	254,500	5,738,473	144,658	602,500	2,859,145	2,069,915	75,360
VII	<b>Të tjera</b>	<b>51,325,000</b>	<b>325,600</b>	<b>115,264,000</b>	<b>41,465,000</b>	<b>65,603,376</b>	<b>118,713,448</b>	<b>880,960</b>
7.1	Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	49,504,000	192,400	115,204,000	41,465,000	65,603,376	118,493,448	0
7.2	Shpenzime gjyqësore	1,821,000	133,200	60,000	0	0	220,000	880,960

## 6. TRANSPARENCA E UNIVERSITETEVE PUBLIKE

Në përgjigje të një ndër kërkesave kryesore të protestës së studentëve në dhjetor 2018, qeveria nxorri VKM nr. 781 për garantimin e transparencës së institucioneve të arsimit të lartë, pavarësisht ekzistencës së ligjit për të drejtën e informimit dhe detyrimeve që ai parashikon për çdo autoritet publik.




Nga verifikimet e kryera nga ekipi i Qëndresës Qytetare ndër vite ky portal nuk përmbante të dhëna mbi shpenzimet në nivel univiersiteti apo rektorati por vetëm të dhëna në nivel fakulteti, gjë që u vështirësonte studentëve të kuptojnë shpenzimet totale të univiersiteti dhe raportin e shpenzimeve për mënyrën se si harxhohen paratë e tyre.

Por aktualisht dhe në periudhën e monitorimit 2022 – 2023 nga portali u-transparenca janë fshirë të gjitha informacionet, vendimet, cv e pedagogëve dhe prokurimet të cilat janë të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Minsitrave.

Ky precedent jo vetëm që përkeqëson situatën e transparencës së universiteteve publike por vendos përpara përgjegjësisë një seri isntitucionesh të cilat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e këtij portali.

Në pikën “gj” të këtij vendimi parashikohet se brenda u-transparenca.al do të gjenden edhe rezultatet e verifikimit të titujve akademikë, por jo vetëm që kjo kategori nuk është parashikuar por edhe nuk ekziston në këtë portal.



Qëndresa Qytetare ka hasur vështirësi në procesin e mbledhjes së informacionit nga universitetet publike, pasi 4 nga 6 universitetet e monitoruara nuk kanë kthyer përgjigje në afat, ndërsa Universiteti i Tiranës ka refuzuar ti përgjigjet kërkesës së Qëndresës Qytetare, me pretendimin se vënia në dispozicion e kontratave dhe anekseve të tyre çënon sekretin tregëtar të kompanive me të cilat janë lidhur kontratat e blerjeve apo shërbimeve.

QQ paditi pranë Komisionerit për të drejtën e informimit Universitetin e Tiranës dhe ky institucion urdhëroi UT të japë shpjegime. Ky proces është ende në vijim por praktika e krijuar do të dëmtonte në thelb transparencën e universiteteve publike në vend.

Shpenzimet e universitetet, nga analiza e mësipërme, vihet re që janë të fokusuara tek kontratat e restaurimeve, kostot e personelit apo administratës dhe blerjet e shërbimeve rutinë, ndërkohë që në 7 universitetet e marra në shqyrtim ende mungojnë disa shërbime bazike për studentët si:

- Sistemi elektronik i studentëve
- Wi-fi falas për studentët
- Bibliotekat
- Fotokopje dhe printera falas për studentët
- Lëshim i vërtetimeve dhe dokumentacioneve në mënyrë elektronike pa pagesë
- Akses online për revista botërore të fushave të ndryshme shkencore
- Ngrohje – Ftohje në sallat e leksionit

## 8. REKOMANDIME

- Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të zbatojë VKM 781, dt 26.12.2018 duke përditësuar dhe plotësuar me kategoritë që mungojnë protalin u-transparenca. Organet e hetimit mund të nisin një hetim mbi fshehjen e të dhënave të universiteteve ndërsa Gjykata Administrative e Tiranës me kërkesë të personave të tretë mund të urdhërojë zbatimin e kësaj VKM-je
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të inspektojë buxhetet, transaksionet dhe ofrimin e shërbimeve të universiteteve publike sipas parashikimeve të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore në raste shkeljesh.
- Universitetet publike duhet të përditësojnë dhe personalizojnë programet e transparencës në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit dhe të aplikojnë vendimarrje financiare të hapur me përfshirjen e studentëve në konsultim të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Inforimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Universitetet publike duhet të krijojnë kushtet dhe shërbimet minimale për studentët brenda godinave të tyre për të mundësuar printimin, fotokopjet, njoftimet elektronike të vlerësimeve apo vërtetimet elektronike në sekretari.
- Universitetet publike duhet të risin nivelin e transparencës, në raport me studentët, pedagogët dhe qytetaret të cilët janë taksapaguesit kryesorë të universiteteve.
- Universitetet publike duhet të alokojnë më shumë para për zërat e kërkimit shkencor dhe pasurimit të bibliotekave të tyre me librat që përmban kurrikula mësimore dhe më pak para për siguri, rrethim godinash dhe mirëmbajtje të gardheve rrethuese.
- Këshillat Studentore dhe studentët aktivë të bëhen pjesë e vendimmarrjes duke verifikuar çdo blerje, çdo kontratë lidhur me të tretët dhe cdo shërbim të ofruar nga universiteti ku studiojnë.
- Këshillat Studentore dhe studentët të kërkojnë nga anëtarët e Bordit të Administrimit të zgjedhur prej tyre llogari periodike për çdo veprim financiar që ka ndërmarrë universiteti.



